



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2022:191607  
Datë: 10.10.2024  
Numri i dokumentit: 06280151

**Ac.nr.6799/23**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Ardian Ajvazi dhe Malsor Kryeziu - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.J., nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.A.H., nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë - shujtat ditore, vlera e kontestit 370.00€, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm, C.nr.3200/22, të datës 23.08.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datën **03.10.2024** mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm, C.nr.3200/22, të datës 23.08.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.3200/22, të datës 23.08.2023, në pikën *I* të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses A.J., nga Prizreni dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses, në emër të shujtave ditore për 185 ditë pune gjatë periudhës kohore nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, t'ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 370.00 (treqind e shtatëdhjetë) euro, me kamatë ligjore prej 8% të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm, ndërsa në pikën *II* të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditëses A.J., t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124 (njëqind e njëzet e katër) euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afatin ligjor ka parashtruar ankesë për shkak të *shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe*

*zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar, aktgjykin e goditur ta prish dhe ta hedhë poshtë padinë e paditës, apo ta ndryshoj aktgjykin e goditur, ose aktgjykin ta prish dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësja ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës, përmes së cilës e ka kundërshtuar të njëjtën, duke propozuar refuzimin e saj, vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të obligohet e paditura që ti paguaj shumën prej 208 euro për përpilimin e Përgjigjes në Ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, e në mbështetje të nenit 194 dhe 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, me datën 19.09.2022, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, të precizuar me datën 05.06.2023 për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, me arsyet si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pa shqyrtim kryesor të çështjes, ka nxjerrë aktgjykin e atakuar C.nr.3200/22, të datës 23.08.2023, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij. Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka arsyetuar se nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në SHFMU “Mustafa Bakiu” në Prizren, fakt i cili vërtetohet me anë të vërtetimit të lëshuar nga e paditura. Kontestuese nuk ishte as prania e paditës së punë, ku nga vërtetimi nr.493/2022, i datës 22.04.2022, i lëshuar nga e paditura, konstatohet se paditësja prej datës 01.01.2021 e deri me 31.12.2021 ka gjithsej 185 ditë të pranisë në punë, e po ashtu kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë. Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka vendosur se duke ju referuar dispozitës së nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021. Vendimin mbi kamatën e ka mbështetur në nenin 382 par.1 dhe par.2 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e ka bazuar në nenin 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (*më gjerësisht si në arsyetim të aktgjykimit të atakuar*).

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsyet se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara, dhe as në shkeljet nga nenii 182 parag.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare sipas nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nen 182 parag.2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i quartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkaktohet se SHFMU "Mustafa Bakiu" në Prizren, gjë e cila është vërtetuar me anë të vërtetimit e cila gjendet si provë në shkresat e lëndës, e po ashtu janë vërtetuar edhe ditët e pranisë së paditësit në punë për periudhën për të cilën paditësi kërkon kompensimin e ushqimit, përmes vërtetimit të lëshuar nga institucioni në të cilin punon, e i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsy se me nenin 90 parag.1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me parag.1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me parag.3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me parag.4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive*".

Me nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021 parashihet se "*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhëni e punës primare në institucion e arsimorisë. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjeter, nuk ka obligim kompensimin për ushqim*". Edhe sa i përket vlerësimit të kohëzgjatjes së kontratës kjo gjykatë shton se për periudhën prej datës 01.01.2021 e deri më 31.12.2021, vlen dispozita e nenit 35 par.7 e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021 e cila në mënyrë të njëjtë ka paraparë kompensimin e punëtorëve për shujtat ditore. Andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, për çka edhe vendosi që të njëtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses që në emër të kompensimit të ushqimit ditor-shujtës, për periudhën për të cilën

paditësja kërkon kompensimin, t'ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pretendimi ankimor i të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë e ka konstatuar gjendjen faktike me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit pasi që e paditura nuk është palë nënshkruese e Kontratës së Përgjithshme Kolektive dhe se paditësës nuk i takojnë benifitet nga Kontrata Kolektive, kjo gjykatë gjeti se një pretendim i tillë nuk është i bazuar, duke qenë se me nenin 90, paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve.* Me paragrin 1 të këtij neni përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes.*" Me paragrin 3 të këtij neni përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës.*" Me paragrin 4 përcaktohet se: "*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive.*" Ndërsa në nenin 2, parografi 1.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, ndër të tjera thuhet se: "*Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativoh-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës...*", ndaj detyrimi për zbatimin e kësaj kontrate ka fuqinë ligjore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamaten.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.6799/23, datë 03.10.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**